



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 44 në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 4873 prot., datë 08.10.2024, referuar ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Rregullat dhe procedurat lidhur me emërimin në shërbimin civil gjyqësor parashikohen në ligjin nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili në nenin 60, pika 1, ka përcaktuar Këshillin e Gjykatës si organin kompetent për emërimin e nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë. Ndërkohë që, nëpunësi civil gjyqësor në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar duhet të përmbushë edhe kriteret shtesë që përcaktohen në ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar.

Për këtë qëllim, neni 6 i ligjit nr.95/2016, i ndryshuar, ka parashikuar se procedura e verifikimit të pasurisë dhe figurës realizohet nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Komisioni i Posaçëm kryen verifikimet e nevojshme për pasurinë dhe figurën dhe i dorëzon institucionit të emërtesës një raport të hollësishëm mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe pastërtinë e figurës, si dhe çdo dokumentacion tjetër mbështetës të paraqitur nga vetë kandidatët apo institucionet shtetërore, të cilat bëhen pjesë të dosjes së kandidatit, sipas legjislacionit në fuqi.

Për sa më sipër, lutemi që lidhur me ecurinë e procesit tuaj të verifikimit të drejtoheni pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në cilësinë e institucionit të emërtesës, referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!